



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 28 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2859 prot., datë 27.05.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me kërkesën tuaj për vënie në dispozicion të raporteve të monitorimit të buxhetit për vitin 2023, të gjykatave administrative të shkallës së parë Lushnje dhe Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj, në 30 (tridhjetë) fletë gjithsej.

Në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të propozimeve për ndryshime ligjore të miratuara Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, bashkëlidhur gjeni propozimet ligjore të përcjella pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Shqipërisë si dhe komunikimet shkresore mes institucioneve, në 21 (njëzetë e një) fletë gjithsej, si më poshtë:

- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.
- Shkresë e KLGJ-së nr. 5627 prot., datë 26.10.2023, mbi përcjelljen e propozimeve ligjore të mësipërme.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.
- Shkresë e KLGJ-së nr. 4244/13 prot., datë 12.03.2024, mbi përcjelljen e propozimeve ligjore të mësipërme.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

- Shkresë e KLGJ-së nr. 1987 prot., datë 03.04.2024, mbi përcjelljen e propozimeve ligjore të mësipërme.
- Kthim përgjigje nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me shkresën nr. 1987 prot., datë 03.04.2024.
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Shkresë nr. 4244/17 prot., datë 17.04.2024, mbi përcjelljen e propozimeve ligjore të mësipërme.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit qeverisës të sistemit gjyqësor, i ngarkuar nga Kushtetuta për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në qershor të vitit 2022 ka propozuar disa ndryshime ligjore që konsistojnë në përmirësimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e kryetarëve të gjykatave. Aktualisht, këto propozime ndodhen në fazë konsultimi pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Për më tepër, bashkëlidhur po ju vendosim në dispozicion komunikimet shkresore mes Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me vijimësinë e procedurës së shqyrtimit të këtyre propozimeve, në 3 (tre) fletë gjithsej.

Ndërsa lidhur me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të raportimeve të auditit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të zhvilluara gjatë vitit 2023 në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kukës dhe Durrës; gjykatat administrative të shkallës së parë Tiranë dhe Lushnje; Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të të dhënave që përmbajnë këto raporte, Këshilli, bazuar në nenin 9/1, pika 2, shkronja f) të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ka kërkuar vlerësimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëse duhet t’jua vendosë në dispozicion dokumentacionin e mësipërm.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!